

Bedri MUHADRI

KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOMUNËN E PRIZRENIT DHE NË FSHATRA E HASIT (1998-1999)

Në periudhën janar 1998 deri më 12 qershor 1999, në bazë të të dhënave të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dhe disa organizatave joqeveritare, në territorin e komunës së Prizrenit janë vrarë 328 banorë civilë (260 meshkuj dhe 68 femra). Në luftime të drejtpërdrejta me armikun 143 ushtarë të UÇK-së kanë rënë dëshmorë.¹ Në territorin e komunës së Prizrenit, me 78 vendbanime, janë kryer edhe masakra, ku më të theksuarat janë: ajo në Dardhëz (ish-Krusha e Vogël), Lugishtë të Hasit (ish-Lubizhda e Hasit), Korishë, Lagjen “Tusus” të Prizrenit, Landovicë etj. Më 24 mars 1999, forcat serbe filluan të garantojnë fshatin Qëndresë (ish-Randrobravë). Gjatë pasdites së 25 marsit, ushtria dhe paramilitarët serbë kishin plaçkitur e djegur pjesën e poshtme të fshatit Qëndresë.

Në vatrat e tyre forcat serbe vranë Magjun dhe Gjylferie Hoxhën. Bombardimi i fshatit kishte vazhduar tërë ditën e 25 marsit 1999. Si pasojë nga granatimet serbe vriten shtatë anëtarë të familjes Pajaziti: Shejh Amrush Pajaziti, Alemshahe e Mejreme Pajazitit, si dhe fëmijët: Ilirjana, Gentijana, Kosovarja dhe fëmija dyvjeçar Riadi.² Po ashtu, gjatë ditës ishin vrarë disa banorë, si vëllezërit Haziz e Xheladin Bytyqi, Rexhep Rexhepi, Rifat Bajrami, Islam e Veli Hoxha dhe Orhan Osmani. Masakra në Dardhëz e kryer nga forcat serbe më 25 mars të vitit 1999, një ditë pas fillimit të bombardimeve mbi caqet ushtarake serbe, është ndër masakrat më të rënda, që forcat serbe ngaqë kishin hyrë në Dardhëz, banorët i dërgojnë në një mal të afërt mbi fshat. Ditën e nesërme më 26 mars të gjithë banorët i grumbullojnë në oborrin e një shtëpie, ku i ndajnë burrat nga gratë dhe fëmijët, ndërsa pasi i plaçkitin burrat, i urdhërojnë që të qëndrojnë dy orë me duar prapa kokës, kurse grave e fëmijëve u kishin thënë “*Shkoni për Shqipëri e mbytuni në Dri*”. Në mbrëmje i kanë futur në një shtëpi në dy dhoma rreth 120 burra. Aty shtijën në ta dhe pastaj për t’i humbur gjurmët ia

¹ Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, 2, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 171.

² Qazim Morina, *Ngjarjet e lavdisë*, Shtëpia Botuese “Altera”, Prizren, 2021, f. 52.

shtinë flakën shtëpisë.³

Për kryerjen e kësaj masakre banorët i fajësojnë edhe fqinjët e tyre serbë, të cilët u ishin bashkëngjitur formacioneve paraushtarake e policore. Në këtë masakër serbët e armatosur, civilë, ushtarë e policë paramilitarë, vranë e masakruan 113 meshkuj nga 12 deri në 77-vjeçar.⁴ Disa nga dëshmitë e mbledhura për masakrën, u janë dorëzuar më herët prokurorëve ndërkombëtarë të misionëve të OKB-së dhe BE-së. Një pjesë e tyre shërbeu për të ngritur aktakuzë ndaj Drako Tasiqit, njërit nga serbët e këtij fshati, të cilin më 2020, Gjykata e Prizrenit e ka dënuar me 22 vjet burgim për pjesëmarrje në masakër. Më vonë, Gjykata e Apelit në Kosovë, dënimin ndaj Tasiqit e ka ulur në 11 vjet burgim.⁵

Më 26 mars 1999, rreth orës 11:00 në qendrën e fshatit Landovicë është zhvilluar një betejë ndërmjet 4 ushtarëve serbë dhe tre pjesëtarë të forcave të UÇK-së. Në luftime të drejtpërdrejta u vranë tre ushtarë serbë, kurse nga forcat e UÇK-së, Heshim Gashi u plagosë rënd, e pas një dite vdes. Një orë më vonë pas kësaj ngjarjeje, forcat ushtarake serbe ndërmorën aksione luftarake kundër popullatës civile në Landovicë. Forcat ushtarake serbe hapën zjarre artilerie nga tanket që ishin të pozicionuara në Landovicë në rrugën Gjakovë-Prizren në drejtim të fshatit Landovicë. Predhat e para e kishin goditur shtëpinë e Ismet Gashit ku kishte të strehuar rreth 45 banorë, kryesisht gra, fëmijë dhe të moshuar. Predha armike kishte depërtuar në brendësi të shtëpisë, ku si pasojë e shpërthimit të saj mbeti e vranë Njomëza Morina, 16-vjeçare. Fshati është granatuar deri në ora 15:00. Popullata e Landovicës kishte dalë nga shtëpitë dhe ishte futur në pyll aty afër. Ushtria serbe hyri në brendësi të fshatit dhe vrau 5 vetë të moshuar, të cilët nuk ishin larguar nga shtëpitë e tyre. Të nesërmen më 27 mars, pjesëtarët e ushtrisë serbe me eksploziv e rrëzojnë minaren e xhamisë së fshatit. Viktimat e krimit në Landovicë janë: Njomëza Ibish Morina (1983), Dalifë Hazer Gashi (1923), Afrim Eqrem Gashi (1981), Fatime Selma Morina (1955), Festina Islam Morina (1987), Luljeta Haxhi Qerreti (1965), Bukurie Xhemail Qerreti (1971), Diellza Selajdin Qerreti (1998) Nazmie Haxhi Qerreti (1984), Gëzim Haxhi Qerreti (1990), Kosovare Nazim Selimaj (1998), Kushtrim Nazim Selimaj (1991), Avdi Ragip Gashi (1993), Avdi Haxhi Morina (1935), Hadije Mustafë Gashi (1924), Shefki Ali Jahaj (1994) dhe Abaz Sejdi Krasniqi (1997). Në Landovicë u plagosën edhe 13 banorë.⁶

³ J. Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë*, f, 173.

⁴ Morina, *Ngjarjet e lavdisë*, f, 43.

⁵ *Po aty*, 43.

⁶ *Po aty*, 49.

Më 27 mars 1999, kriminelët serbë dogjën Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë rast u dogjën 188 dokumente me vlera historike, përfshirë gjësende personale dhe eksponatet me vlera të mëdha të trashëgimisë shqiptare. Ky objekt përmban trashëgiminë më të qartë kombëtare shqiptare. Ajo është emblema e shqiptarisë, është lëvizja me përmbajtje dhe me vlera më të mëdha shqiptare, me qëllime politike, administrative e ushtarake. Vandalizmi serb u shfaqë barbarisht duke e djegur Muzeun e më pas fshirjen e gjurmëve, asgjësimin e çdo materiali e objekti me vlera të trashëgimisë kulturore e historike shqiptare, duke e pastruar vendin, të cilin e kthyen në vend të mbjellë me lule. Sipas Adnan Beqirit që ka jetuar në afërsi të Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, një natë para djegies, në Muze ishte hedhur një bombë, ndërsa pas tri ditësh filloi humbja e gjurmëve, duke larguar bustet e patriotëve kombëtarë, Abdyl Frashëri e Ymer Prizreni.⁷ Banorët e kësaj lagjeje edhe sot i përkujtojnë me dhembje të madhe ato momente rrëqethëse. “...Nuk u dogj vetëm një pjesë e historisë, por edhe një pjesë e shpirtit tonë...”⁸ Për fat të keqë, sot e kësaj dite askush nga kriminelët e “mesjetës moderne” nuk është dënuar për aktin e djegies së rezidencës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Më 28 nëntor 1999, Komuna e Prizrenit bëri inaugurimin e Shtëpisë së rindërtuar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Më 13 maj 1999, ushtria serbe inskenoi një masakër të tmerrshme në fshatin Korishë. Forcat ushtarake serbe përdorën një kolonë të refugjatëve shqiptarë të nisur në drejtim të Shqipërisë, duke e ndalur në rrugë, për ta përdorur si mburojë ndaj bombardimeve të NATO-s. Në një situatë të tillë të maskuar nga ushtria serbe, NATO-ja gjuan përmes aeroplanëve bombardues ku vriten 77 persona, në mesin e tyre edhe tri foshnje, si dhe 14 nxënës të shkollës, ndërsa 61 persona të tjerë janë plagosur. Viktimat ishin kryesisht nga fshati Korishë, si dhe nga fshatrat tjera. Pas këtij rasti zyrtarët serbë kishin sjell ekipe televizive në vendngjarje. Televizioni serb tregon skena shkatërrimesh, trupa të djegur, traktorë të djegur e shkrirë. Qeveria jugosllave këmbëngulte që NATO-ja kishte në shënjestër civilë. Ndërsa të mbijetuarit shqiptarë pretendonin se ata ishin vendosur nga autoritetet jugosllave si mburoja njerëzore, në mënyrë që të vriteshin nga bombat e NATO-s.⁹ Më 26 maj 1999 në “Lagjen e Trimave” (ish-Lagjen Tuzuzi) në Prizrenit pas një lufte të drejtpërdrejtë mes UÇK-së dhe forcave serbe, ndodhi masakra e rëndë ku u vranë 25 meshkuj të kësaj lagjeje. “Lagjja e Trimave” ishte baza kryesore e UÇK-së. Forcat ushtarake të UÇK-së më 26

⁷ Po aty, 55.

⁸ Po aty, 55.

⁹ Po aty, 66.

maj 1999 në ora 07:30 të mëngjesit, duke kontrolluar këtë territor gjatë një aksioni vrasin dy policë të njësisë speciale serbe. Forca të shumta ushtarake e policore, në pamundësi të shkatërrimit të bazave të UÇK-së, në “Lagjen e Trimave”, qysh në orët e paradites së 26 majit 1999, ndërmorën një ofensivë gjithëpërfshirëse me karakter hakmarrës mbi popullatën e pafajshme civile, duke vrarë 25 veta të paarmatosur. Viktimat më pastaj i ngarkonin në kamion dhe i dërgonin në vende të caktuara për të humbur gjurmët e krimit. Kjo masakër është kryer nga forcat speciale të policisë, në bashkëpunimin me formacione të përziera paramilitare, të cilat kishin të veshura uniforma kamuflazhi (të gjelbëritë), një pjesë mbanin maska në fytyrë, ndërsa pjesa tjetër kocat i kishin të lidhura me shami.¹⁰

Pushteti serb në vitet 1997-1999 bëri masakra të shumta edhe në shumë fshatra të Hasit. Hasi është krahinë e Kosovës, e cila numëron 42 fshatra me afërsisht 32 000 banorë. Administrativisht krahina e Hasit bënë pjesë në dy njësi administrative territoriale, në atë të komunës së Gjakovës dhe të Prizrenit. Dhuna në Has nga autoritetet pushtuese serbe u shfaqë edhe në vitet e ‘90-ta, në kohën e okupimit dhe administrimit tërësisht serb, përballë organizimit tonë gjithëpopullor për liri dhe pavarësi. Prej vitit 1990 e deri në vitin 1998 u vranë dhjetëra qytetarë. Vrasjet ndodhën në Malin e Pashtrikut, gjegjësisht në afërsi të kufirit Kosovë-Shqipëri, qytetarët të cilët në kërkim të lirisë dhe prosperiteti ia mësynin kufirit për të dalë në Shqipëri. Kufiri në këtë zonë konsiderohej i rrezikshëm nga qëndrimi permanent i forcave të shumta ushtarake serbe në këtë zonë kufitare dhe për pasojë u vranë shumë të rinj në përpjekje për ta kaluar kufirin.

Në qershor të vitit 1998, në fshatin Demjan u vendosën dy kampe të mëdha ushtarake serbe, njëri prej tyre në lagjen “Pnishi”. Ky kamp hyri në Shkollën Filllore “Pjetër Bogdani”, duke ndërprerë mësimin dhe përjashtuar nga mësimi mësuesit dhe nxënësit. Në objektin e shkollës u vendos shtabi ushtarak serb i këtij kampi.¹¹ Kampi tjetër u vendos në “Lagjen e Shehut”. Nga vrojtimet e mundshme dhe nga shfaqja e tyre shihej se bëhej fjalë për forca të mëdha ushtarake, me teknikë të lartë ushtarake. Më 19 korrik 1998, në fshatrat e Hasit filloi ofensiva e parë me ç’rast u rrethuan pothuajse të gjitha fshatrat e Hasit me pretekst të kërkimit të armëve dhe më 20 korrik u dogjën 48 shtëpi, si në: Romajë, Blinishtë, Demjan, Gërqinë e në fshatra të tjera.¹² Po ashtu, në këtë ofensivë serbe, në tërë territorin e Hasit, u dogj lama e fshatarëve. Dhuna në Has nga ana e okupatorit serb shkallëzohej

¹⁰ *Po aty*, 68.

¹¹ Deklaratë gojore nga Besim Muhadri, i cili ishte drejtor i Shkollës Filllore “Pjetër Bogdani”, Demjan, 2022.

¹² Çoçaj, *Dhuna në Has*, f. 8.

vazhdimisht. Kështu gjatë dy viteve 1998-1999 në Has ndodhën dhe shumë vrasje dhe katër masakra.

Në tetor të vitit 1998, në Beograd ambasadori amerikan Richard Holbruk nënshkroi marrëveshjen me udhëheqësin serb, Slobodan Millosheviqin, “kasapin e Ballkanit”, me anë të së cilës në Kosovë u vendos Misioni Vëzhgues Evropian, që kishte mandat të vëzhgonte luftën dhe të sillte vendime në favor të paqes. Kjo marrëveshje u kuptua si mundësi e stabilizimit të situatës së luftës çlirimtare në Kosovë. Shumë familje hasjane, të cilat për shkak të dhunës që ushtrohej gjatë verës së vitit 1998 në fshatrat e Hasit ishin strehuar në Shqipëri, të bindur se ushtria serbe tani mund të jetë nën kontroll të misionit evropian, nisën të ktheheshin në vatrën e tyre. Njëra ndër familjet që po kthehej ishte familja Sulmetaj e fshatit Gërqinë. Duke u kthyer në shtëpi, kjo familje e paarmatosur vetëm me gjësende dhe fëmijët e tyre në krah, 300 metra para se të arrinin në shtëpitë e tyre në Gërqinë, ushtria serbe duke e vënë në pritë ushtarake vranë katër pjesëtarë të familjes Sylmetaj: Ramiz Sylmetaj, Muharrem Sylmetaj, Leonorë Sylmetaj (12-vjeçare) dhe i mituri Mazllum Sylmetaj 2-vjeçar.¹³

Më 25 mars 1999 një ditë pasi predhat e aeroplanëve të NATO-s kishin goditur disa nga caqet serbe në Beograd, Prishtinë e Podgoricë, trupat ushtarake serbe bënë krimin më makabër të asaj kohe në fshatin Goden të Gjakovës, duke vrarë dhe djegur njëzet burra, në mesin e të cilëve edhe dy mësues dhe drejtorin e shkollës së këtij fshati, Ali Ferin. Datën e vrasjes së tyre dhe aktin makabër e dëshmon ora e dorës e të vrarit Ali Ferit e gjetur pas lufte si gjurmë krimi, në të cilën ende shihen gjurmët e dorës së djegur. Si për dëshmi, akrepat e ndaluar të orës tregojnë ndoshta më së miri aktin e kryerjes së krimit nga ana e kriminelëve serbë. Ishte ora 11:15 minuta, më datë 25 mars.

Banorët e fshatit Goden ndihmuan në tërësi luftën çlirimtare. Ata kontribuan në mbajtjen e lidhjeve me Shqipërinë, në mbështetjen e UÇK-së, ruajtjen e korridoreve lidhëse të UÇK-së me Shqipërinë në realizimin e bartjes së armatimit për UÇK-në. Ky kontribut i madh i banorëve të fshatit Goden bëhej në mënyrë të organizuar nga tërë banorët e fshatit dhe me vigjilencë të madhe në dobi të UÇK-së. Banorët e fshatit Goden, shtëpitë e veta i bënë strehimore të UÇK-së, të cilët bënë rrugë të largët dhe në Goden ushtarët e UÇK-së, pushonin dhe pritnin momentet me të përshtatshme për të kaluar kufirin që ishte shumë pranë fshatit. Ditën ushtarët e UÇK-së pos strehimit edhe ushqeheshin nga banorët e fshatit Goden dhe merrnin përkrahje dhe ndihmë logjistike.¹⁴

¹³ *Po aty.*

¹⁴ Deklarët nga Xhevdet Morina, Goden, 2022.

Pushtuesit serbë, të indinjuar nga kjo situatë, aspak e lakmueshme për ta, tani në mënyrë edhe më të shfrenuar, filluan hakmarrjen mbi popullatën e fshatit Goden. Fillimisht forcat pushtuese serbe, hynë nëpër shtëpi dhe bënë dëbimin e banorëve nga vatrat e veta. Banorët e fshatit i grumbulluan në afërsi të shkollës fillore. Ushtria serbe u thoshte: *“Tani juve do t’ju mbrojë NATO, ku është ajo”*. Më pastaj, u dogjën shtëpitë dhe objekti shkollor. E gjithë kjo po bëhej para syve të fshatarëve. *“Ua dogjëm shtëpitë, tash po ua djegim edhe shkollën, sepse këtu mësuesit e juaj me vite të tëra u kanë mësuar ju dhe fëmijëve tuaj se si të na urreni dhe si të mos e doni Serbinë dhe ta luftoni atë”*, - u thoshin ushtarët serbë fshatarëve dhe nxënësve të zënë robër lufte.

Ushtarakët serbë, në mesin e të zënëve robër me dhunë i marrin 20 meshkuj, të cilët më pas i pushkatuan në prezencë të banorëve e pastaj kufomat e tyre i mblodhën në një shtëpi dhe i dogjën, duke menduar kështu t’i humbasin gjurmët e krimit. Pas mbarimit të luftës, në vendin e krimit u gjetën vetëm disa mbetje mortore, eshtrash dhe gjësendesh, të cilat u identifikuan se janë mbetje mortore të 20 meshkujve të varë më 25 mars 1999. Mbetjet mortore të 20 meshkujve, ato pak eshtra dhe ato pak gjësende, u varrosën në mes të fshatit, në një varr të përbashkët në shtator të vitit 1999. Në mesin e atyre 20 burrave të fshatit Goden, që u vranë dhe u masakruan, ishin: atdhetari dhe drejtori i Shkollës Fillore, “Malush Stavileci”, Ali Feraj 40-vjeçar dhe dy mësuesit e kësaj shkolle, Mehmet Osmanaj 26-vjeçar, Bashkim Osmanaj 24-vjeçar, Sali Osmanaj 49-vjeçar, Miftar Osmanaj 50-vjeçar, Hamëz Osmanaj 40-vjeçar, Zymer Osmanaj 22-vjeçar, Bedri Osmanaj 24-vjeçar, Faik Osmanaj 20-vjeçar, Jonuz Morina 63-vjeçar, Ramë Feraj 44-vjeçar, Hysen Feraj 40-vjeçar, Binak Feraj 36-vjeçar, Islam Morina 30-vjeçar, Vesel Morina 29-vjeçar, Blerim Morina 23-vjeçar, Metush Morina 30-vjeçar, Shaban Feraj-vjeçar, Neshat Feraj 47-vjeçar.¹⁵

Masakra e Rogovës 29 janar 1999. Pas masakrës së Reçakut (më 15 janar) dhuna e okupatorit serb në fshatrat e Hasit u bë edhe më e egër, meqë drejt kufirit me Shqipërinë tashmë në territorin e Hasit kishin ardhur mijëra ushtarë e paramilitarë serbë me mjete të blinduara për ta kontrolluar gjoja kufirin. Dhe kështu në mëngjesin e së premtes së 29 janarit të 1999 forcat serbe rrethuan fshatin Rogovë dhe masakruan me këtë rast 25 shqiptarë, nëntë prej të cilëve ishin banorë të Rogovës, në mesin e të cilëve patë edhe invalidë, ndërsa 16 të tjerë ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare nga Zona Operative e Dukagjinit.¹⁶ Sipas dëshmitarëve, që i kishin shpëtuar kësaj masakre, atë ditë, rreth orës 05:30, ushtarët, policët e paramilitarët

¹⁵ Çoçaj, *Dhuna në Has*, f, 16.

¹⁶ Deklaratë nga Kapllan Hoti, Rogovë, 2022.

serbë, pasi e kishin futur në rrethim të hekurt tërë fshatin, kanë hyrë nëpër shtëpitë e fshatit, i kanë bastisur e demoluar. Popullata, e gjendur para kësaj katrahure, kishte filluar të arratisej në drejtime të ndryshme ose të strehohej ku mundej. Atëherë ushtarakët, paraushtarakët dhe policët serbë vranë e masakruan ata që zunë - kë mundën dhe ku mundën. Atë ditë u vranë e masakruan: Agron dhe Sejdi Rama nga Smolica e Gjakovës, Gëzim Ademaj nga Ratisha e Deçanit, Agush Gjoci nga Raushiqi i Pejës, Agim Zeneli dhe Luan Islami nga Shqiponja e Dushkajës, Sahit Krasniqi nga Ratkoci i Përdrinit, Daut Zagraxha nga Banja e Burimit, Haxhi Lipjani nga Kleçka e Malishevës, Valon Gashi nga Buçani i Pejës, Vesel Avdyli nga Drenoci i Klinës, Emrush Çeta nga Turbovci i Burimit, Bahtjar Morina nga Lubizhda e Malishevës dhe Naim Dreshaj nga Vrella e Burimit. Që të gjithë ishin ushtarë nga Zona Operative e Dukagjinit dhe ajo e Pashtrikut. Në mëngjesin e 29 janarit forcat kriminale serbe në Rogovë në shtëpitë e tyre masakrojnë: Rrustem Morinën me 3 djemtë Selmanin, Nysretin dhe Mehmetin, pastaj Ibrahim Kryeziun, Adem Shalën, Rifat Shalën, Zyber Shalën dhe Xhevdet Berishën. Po atë ditë në fshatin Ujëz të Gjakovës është vrarë ushtari i UÇK-së, Gaspër Karaqi.¹⁷

Pas shumë masakrave dhe torturave të shumta forcat serbe vazhdojnë të dëbojnë popullatën nga shtëpitë e tyre dhe dërgimin e saj në drejtim të Shqipërisë. Krahas qindra e mijëra banorëve të Kosovës që po përjetonin një akt të tillë, të njëjtën gjë po e përjetonin edhe 30 000 mijë banorët e Hasit. Në këtë regjion dëbimi më i madh nga trojet stërgjyshërore nis më 29 mars të vitit 1999. Në këtë ditë popullata e Hasit, e grumbulluar në vende të shumta, marrin drejtimin për në Shqipëri. Në rrugëtimin drejt Shqipërisë, forcat serbe, diktonin se kah do të kalonin kolonat e gjata të popullatës së Hasit në drejtim të pikës kufitare në Morinë. Më 29 mars kolonat kishin mbushur rrugën në drejtim të Morinës. Në mundësit vetanake popullata e Hasit duke ndihmuar njëri-tjetrin, duke u bartur me makina tërheqëse, kryesisht me traktorë të mbushur plot e përplot, kanë ndjekur rrugën e depërtimit, nga zona e brendshme e Hasit. Në fshatin Demjan në lagjen “Pnishi” janë grumbulluar popullatat e fshatrave të Demjanit, Blinishtës, Gërqinës, Kushninit dhe kanë vazhduar rrugëtimin për në Rogovë. Nga aty nuk është lejuar nga ushtria serbe të hynin në rrugën magjistralen Gjakovë-Prizren. Janë detyruar të marrin rrugën Rogovë-Romajë deri në fshatin Gjonaj. Te ura e këtij fshati kanë marrë drejtimin nga Nasheci për në drejtim të Zhurit dhe kanë arritur në pikën kufitare në Morinë më datën 29 mars 1999 dhe kanë kaluar në Shqipëri në drejtim të qytetit të Kukësit. Të njëjtën rrugë në drejtim të Shqipërisë e përshkuan

¹⁷ *Po aty.*

edhe fshatrat, si: Luginisht, Lukinje, Gjonaj, Krajku, Qollaku. U dëbuan dhunshëm më se 30 000 banorë të Hasit. Në fshatrat e braktisura, hyjnë forcat serbe duke plaçkitur e më pas edhe duke i djegur shtëpitë dhe gjithë pasurinë e popullatës. Fatin e pothuajse të gjitha fshatrave të Hasit do ta përjetojnë edhe fshatrat e shumta në tërë Kosovën.¹⁸

Masakra e Luginishtës, 12 prill 1999

Pas përzënies me dhunë të popullatës nga shtëpitë e tyre, nëpër fshatrat e Hasit kishin mbetur të strehuar nëpër male edhe mbi 300 qytetarë hasjanë, në mesin e të cilëve edhe fëmijë, gra e pleq, si nga Luginisht, Kabashi, Kushnini, Demjani, Gjonaj Mazrreku e fshatra të tjera, të cilët okupatori serb i ndoqi dhe i vrau kudo që i zinte. Kështu në fshatin Dedaj dy shtëpi ishin shndërruar në kampe të dhunës, ku maltretoheshin dhe vriteshin banorët e pambrojtur të fshatrave të Hasit. Më 12 prill 1999 mbi fshatin Luginishtë në afërsi të “Rrethit të korbit” u masakruan 18 qytetarë hasjanë, prej të cilëve 15 nga Luginisht, që të gjithë u vranë nga afërsia dhe pastaj u masakruan. Mbi të vrarët u bë edhe një masakër tjetër ku kufomat e tyre u mbuluan me gurë, duke ua lënë pjesët e trupit jashtë. Me këtë rast u masakruan: Sinan Gigollaj 28-vjeçar, Mehmet Nerjovaj 37-vjeçar, Latif Nerjovaj 47-vjeçar, Rexhep Nerjovaj 47-vjeçar, Murteza Nerjovaj 52-vjeçar, Lulëzim Nerjovaj 17-vjeçar, Islam Nerjovaj 53-vjeçar, Osman Nerjovaj 43-vjeçar, Tafë Nerjovaj 34-vjeçar, Kada Nerjovaj 79-vjeçare, Razë Kajdomçaj 77-vjeçare, Besim Parrallankaj 27-vjeçar, Arben Gegollaj 16-vjeçar, Nexhat Gegollaj 22-vjeçar, Neki Nerjovaj 49-vjeçar, të gjithë nga Luginisht. Shyqeri Krasniqi 43-vjeçar, Qazim Krasniqi 39-vjeçar, Abdylallah Krasniqi 56-vjeçar nga fshati Demjan.¹⁹

Pas kthimit të popullatës hasjane në trojet e tyre, të plaçkitura e të djegura nëpër fshatrat e Hasit u zbuluan edhe pesë varre masive si në Mazrrek, Milaj dhe Gurishtë, në të cilat varre u gjetën trupat e pajetë edhe të 62 shqiptarëve 13 prej të cilave kufomave u identifikuan nëpër fshatrat e Përdrinisë (Podrimes), përkatësisht komunës së Rahovecit. Ndërsa të tjerët ishin hasjanë edhe pse 11 prej tyre nuk u identifikuan fare, të cilët ishin vrarë e masakruar nga policia dhe paramilitarët serbë, më 25 dhe 29 prill 1999. Shumica e të masakruarave në këto varre ishin nga Luginisht, Kushnini, Demjani, Kabashi e fshatrave tjerë. Të vrarët e të masakruarit: Mustafë Gegollaj, Agim Gegollaj, Xhafer Gegollaj, Ylber Gegollaj, Selman Gegollaj, Afrim Gegollaj, Xhemë Gegollaj, Gëzim Gegollaj, Beqir Gegollaj,

¹⁸ Deklaratë nga Besim Muhadri, Demjan, 2020.

¹⁹ Deklaratë nga Fejz Kabashi, Kabash, 2022.

Shefqet Gegollaj, Beqir Gegollaj, Nijazi Muçaj, Avdullah Muçaj, Abedin Muçaj, Selim Muçaj, Afrim Kajdomçaj, Rifat Parallanka, Zenun Parallanka, Skender Parallankaj, Teki Nerjovaj, Hsan Memçaj, Jeton Memçaj, Gëzim Krasniqi, Skender Krasniqi, Tahir Morina, Njazi Morina, Rrustem Thaqi, Adem Qarri, Rexhë Beçaj, Ramiz Sadik Beçaj.²⁰

Përpos këtyre varreve masive nëpër fshatrat e Hasit u gjetën edhe shumë të vrarë e të masakruar tjerë. Kështu pesë kufoma tjera u gjetën në puse, tri kufoma në lagjen “Pnish” të fshatit Demjan (vëllezërit Imer e Zymer Pnishi, dhe një grua e pidentifikuar, që ishte nga Gjakova) dhe dy kufoma në Dedaj (Naim Temaj dhe Florim Temaj). Në fshatrat e Hasit okupatorët serbë kishin vrarë e masakruar edhe shumë qytetarë tjerë, madje duke i djegur në flakë të shtëpive edhe shumë pleq siç është rasti me katër pleqtë të Kojushit e të Mazrekut si Dinë Qunaj 79-vjeçar, Metë Kukaj 89-vjeçar, Halime Qunaj 84-vjeçare, Tixhë Karavidaj 78-vjeçare e shumë raste të tjera, që gjithsej kapin shifrën 164.²¹ Këtu nuk bëjnë pjesë dëshmorët e lirisë nga regjioni i Hasit, të cilët përfaqësojnë 40 vetë. Masakrat serbe në Prizren e rrethinë dhe në regjionin e Hasit janë dëshmi e gjenocidit serb ndaj shqiptarëve, ku shteti serb kishte për qëllim jo vetëm pushtimin e plotë të Kosovës, por edhe spastrimin etnik të saj nga popullsia shqiptare.

²⁰ Çoçaj, *Dhuna në Has, Violence in Has*, f. 24.

²¹ *Po aty*, f. 26.

